

inspektoriati
i punës



INSPEKTIMI I PUNËS

VITI 2014

KRYEINSPEKTORI

DRITAN YLLI

Raporti mbi aktivitetin e shërbimit të inspektimit të punës përmban:

1. Hyrje
2. Listë të ligjeve dhe rregulloreve të miratuara.
3. Të dhëna mbi shërbimin e inspektimit të punës:
 - ✓ Numri total i inspektorëve
 - ✓ Numri i inspektorëve të kategorive të ndryshme
 - ✓ Numri i inspektorëve femra
 - ✓ Të dhëna mbi shpërndarjen gjeografike të shërbimit të inspektimit..
4. Statistika të subjekteve ekonomike që i nënshtrohen kontrollit të inspektimit dhe numri i personave të inspektuar në to dhe pikerisht:
 - ✓ Numri i subjekteve që i nënshtrohen kontrollit
 - ✓ Numri mesatar i personave të punësuar në këto subjekte gjatë vitit
 - ✓ Të dhëna mbi klasifikimin e personave të punësuar sipas kriterëve burra, gra, femijë
5. Statistika të vizitave të inspektimit që tregojnë pikërisht:
 - ✓ Numri i subjekteve të vizituara
 - ✓ Numri i vizitave të inspektimit të kryera, të klasifikuara sipas asaj nëse ato janë kryer ditën ose natën
 - ✓ Numri i personave të punësuar në subjektet e inspektuara
6. Statistikat e shkeljeve ligjore dhe të sanksioneve që tregojnë pikërisht:
 - ✓ Numri i shkeljeve dhe numri i subjekteve të sanksionuara
 - ✓ Të dhëna mbi klasifikimin e shkeljeve sipas dispozitave ligjore
 - ✓ Të dhëna mbi sanksionet e apeluara
7. Statistika të aksidenteve në punë që tregojnë pikërisht numrin e aksidenteve të deklaruar dhe të dhënat mbi klasifikimin e këtyre aksidenteve:
 - ✓ Sipas industrisë dhe vendit të punës
 - ✓ Sipas shkakut të tyre
 - ✓ Në aksidente vdekjeprurese dhe jovdekjeprurese
8. Statistika të sëmundjeve profesionale që tregojnë pikërisht:
 - ✓ Numri i rasteve të deklaruar të sëmundjes profesionale
 - ✓ Të dhëna mbi klasifikimin e tyre sipas industrisë dhe vendit të punës
 - ✓ Të dhëna mbi klasifikimin e tyre sipas shkaqeve dhe karakteristikave të tyre (natyra e sëmundjeve profesionale, natyra e substancave toksike) të cilave u detyrohet sëmundja profesionale.

- Kemi krijuar një sistem inspektimi profesional, të ndershëm dhe efektiv, realizuar në mënyrë integrale nga Drejtoria Qendrore deri tek inspektori i punës në terren.
- Kemi çuar inspektimin edhe te të paprekshmit deri dje, duke synuar që të gjithë punëmarrësit në territorin e Shqipërisë të ndjejnë mbrojtjen e të drejtave të tyre të ligjshme, përmes Inspektoratit të Punës.
- Kemi arritur hapjen e institucionit, kundrejt përfaqësuesve të biznesit duke vendosur ura bashkëpunimi dhe komunikimi të ndërsjelltë. Kjo është bërë e mundur përmes organizimit të tryezave të rrumbullakta, dëgjësive dhe takimeve me ta në qarqet më të rëndësishme, për të gjetur rrugë të reja për arritjen e qëllimit të përbashkët, atë të luftës kundër informalitetit në tregun e punës dhe berjen e vendeve të punës me të sigurtë dhe të shëndetshme.

Kemi luftuar informalitetin duke dhënë kontribut të vlefshëm në formalizimin e punësimit.

- Kemi evidentuar dhe raportuar në organet e tatim-taksave, 2886 subjekte, krejtësisht informale gjatë aksionit të zhvilluar, me qëllim evidentimin e zonave të inspektimit nga çdo inspektor pune. Në këto subjekte informale, rezultojnë të punonin krejtësisht të pambrojtur, 4638 punonjës.
- Kemi evidentuar punëmarrës informal, në subjekte të licensuara 1757 punëmarrës nga 1031 për të njëjtën periudhë më parë ose 1.7 herë më shumë.
- Dhe nëse e analizojmë informalitetin në raport me numrin e subjekteve të inspektuara, për periudhat krahasuese respektive, kemi evidentuar 26 % më shumë punëmarrës informal për subjekt.
- Pra, kemi evidentuar gjithsej 6395 punonjës ilegale, të cilët përveçse të pambrojtur janë njëkohësisht dhe kontribues të munguar në skemën e sigurimeve shoqërore. E thënë ndryshe janë rreth 39 milione lekë, të munguara në buxhetin e shtetit.

Jemi fokusuar fort tek mbrojtja e punëmarrësve nëpërmjet krijimit dhe bërjes së vendeve të punës të sigurta dhe të shëndetshme.

- Implementimi i metodave të reja inspektuese, orientimi i procesit të inspektimit në drejtim të kontrollit të subjekteve që paraqesin rrezikshmëri të lartë në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë të punëmarrësve, apo dhe për evidentimin e punëmarresve të padeklaruar, i atyre që punojnë pa marë të drejtat që ju jep ligji për orët e zgjatura në punë, për punë të vështira e të pa paguara, ka çuar në rritjen e inspektimeve tematike, në 56% me shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
- Më shumë punëmarrës të informuar ndaj kërkesave, për kushte pune dhe mbrojtje në ushtrimin e profesionit të tyre, për kohëzgjatje pune, paga, sigurime, higjienë dhe mirëqenie. Orjenitimi i drejtë i inspektimeve, ka çuar në rritjen e evidentimit të punëmarrësve që punojnë në turne të dyta, të treta, ditët e pushimit apo festave zyrtare, krahasuar kjo me këto tregues të një viti më parë. Janë rreth 30 mijë punëmarrës të kësaj kategorie, evidentuar më shumë se një vit më parë. Ose nga 2359 evidentuar në 2013, në 32632 evidentuar këtë vit.
- Inspektimet e programuara dhe tematike, kanë çuar në rritjen e evidentimit të punëmarrësve informal në subjektet e licensuara, krahasuar me të dhënat e një viti më parë. Kështu ka një rritje me gati 5 herë të punëmarrësve informal evidentuar në inspektimet tematike, rritje në evidentimin e kësaj kategorie punëmarresish edhe në inspektimet e programuara.
- Në bashkëpunim me perfaqesuesit e ndërmarrjeve, kemi arritur vendosjen e funksionimit të shërbimit të mjekut të ndërmarrjes në 79 subjekte më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë më parë.
- Aktualisht në 124 subjekte më shumë se një vit më parë janë ngritur dhe ka filluar funksionimi i Këshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.
- Si pasojë e kontrollit të vazhdueshëm dhe insistues nga Inspektorati i Punës në drejtim të marrjes së masave kolektive dhe individuale të mbrojtjes, si dhe rritjes së numrit të subjekteve të cilat mbulohen me shërbim mjekësor, për vitin 2014 kemi ulje me 2 herë të numrit të punëmarrësve të diagnostikuar me sëmundje profesionale.

- VKM Nr 562 datë 03.07.2013, Për miratimin e rregullores “Për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Përdorimin e Pajisjeve të Punës në Vendin e Punës”.
- VKM Nr.563 datë 03.07 2013, Për miratimin e rregullores “Për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit për Përdorimin e Pajisjeve Mbrojtëse Individuale në Vendin e Punës”.
- VKM Nr.564 datë 03.07.2013, Për miratimin e rregullores, “Për Kërkesat Minimaletë Sigurisë dhe Shëndetit në Vendin e Punës”.
- VKM Nr. 521, datë 6.8.2014 Për miratimin e rregullores “Për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit për Punën me Pajisje me Ekran Shfaqës”.
- VKM Nr. 523, datë 6.8.2014 Për miratimin e rregullores “Për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit për Mbrojtjen e Punëmarrësve Lidhur me Punën e Krahut me Ngarkesa”.
- VKM Nr. 520, datë 6.8.2014 Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e Sigurisë dhe Shëndetit të Punëmarrësve nga Risqet e Lidhura me Kancerogjenët dhe Mutagjenët në Punë”.
- VKM Nr.522, datë 6.8.2014 Për Miratimin e Rregullores “Për Mbrojtjen e Sigurisë dhe Shëndetit të Punëmarrësve nga Risqet e Lidhura me Agjentët Kimikë në Punë”.
- VKM Nr. 550, datë 27.8.2014 Për Miratimin e Rregullores “Për Mbrojtjen e Sigurisë dhe Shëndetit të Punëmarrësve nga Risqet e Lidhura me Ekspozimin ndaj Agjentëve Biologjikë në Punë”.
- Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë kryer trajnime për të gjithë inspektorët e punës në të gjithë Shqipërinë për njohjen e VKM-ve të reja të dala në zbatim të ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë si dhe janë organizuar seminare për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë me temë:“ VENDE PUNE TË SIGURTA, PROMOVOJNË BIZNESE TË SUKSESSHME”i projektuar për punëdhënësit, menaxherët, dhe specialistët e SSHP.

Rrjeti i inspektimit të punës në Shqipëri

Inspektimi Punes ne Shqiperi operon ne 12 Dege Rajonale ne te gjithë vendin, i drejtuar nga Drejtoria e Inspektoratit Shteteror te Punes dhe Sherbimeve Shoqerore.

Ne te gjithë vendin jane 113 inspektor pune nga te cilet 27% jane femra.

Drejtoria e Inspektoratit Shteteror te Punes dhe Sherbimeve Shoqerore, drejtohet nga

Kryeinpektori i cili ka ne varesi 4 Drejtori:


Drejtoria e Inspektimit per Marredheniet e Punes dhe Statistiken

Drejtoria Shendetit dhe Sigurise ne Pune

Drejtoria e Standarteve te Sherbimeve Shoqerore

Drejtoria e Finances dhe Sherbimeve te Brendeshme

Nr	Degët Rajonale sipas Qarqeve	Kryeinpektor Rajonal	Inspektor/e Pune Total	Inspektore Pune Femra
1	Berat	1	5	2
2	Diber	1	4	0
3	Durres	1	8	2
4	Elbasan	1	8	2
5	Fier	1	7	2
6	Gjirokastër	1	5	0
7	Korçë	1	7	2
8	Kukës	1	3	0
9	Lezhë	1	4	1
10	Shkodër	1	7	2
11	Tiranë	1	32	8
12	Vlorë	1	8	5
TOTALE		12	96	26



Përqëndrimi më i madh i inspektorëve, rezulton të jete në Degën Rajonale Tiranë, për vetë shpërndarjen e subjekteve ekonomike që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri.


Inspektoret femra zënë 27% të totalit të inspektorëve të punës.

Numri i Inspektorëve të punës është i ulët krahasuar me numrin e aktiviteteve ekonomike.

Nga të dhënat e INSTAT, janë rreth 104 mijë Aktivitete Ekonomike, dhe i shpërndarë në kapacitete burimesh njerëzore, është 10 herë më i lartë se numri inspektimeve që mund të kryejë një inspektor pune. Një inspektor pune mund të kryej rreth 110 inspektime në vit.

7


**Raport
2014**



Gjatë vitit 2014 janë realizuar 10890 inspektime, ku 82% e zenë inspektimet e programuara, 16% inspektimet tematike, dhe nga 1% inspektimet për aksident në punë dhe ato për shkak ankese. Disa nga të dhënat e këtyre inspektimeve janë:

Nga Inspektimet ne total	Viti 2014
Subjekte te inspektuara	10890
Punemarres	174240
Mes. Punm/ subjekt	16
Punem.femra	77760
% femra kundrejt totali	44.6%
Punemarres qe punojne me kohe te pjesshme	678
Punemarres ne 18 vjec	265 (ne 660 punm 1 eshte punm nen 18 vjec)
Punemarres te huaj	2236
Subjekte private të inspektuara	10817 (99% e totalit të subjekteve)
Punëmarrës në subjektet private	167603
Mes. Punm/ subjekt (private)	15.5

Numrin më të madh të punëmarrësve në Shqipëri (nga evidentimet në subjektet e inspektuara) e zënë meshkujt. Ndërkohë të dhënat tregojnë se janë punëmarrëset femra që punojnë kryesisht në ndërmarrjet prodhuese, aktivitetet tregëtare dhe aktivitetet e tjera ku përfshihen OJF-të, shkollat, kopshtet, farmacitë, etj.



Punëmarrës të evidentuar gjatë inspektimeve


9

Raport
2014

Nga vetë natyra e aktiviteteve ekonomike që operojnë në Shqipëri janë aktivitetet tregtare që zenë peshën më të madhe të aktiviteteve të inspektuara, duke zënë 50% të totalit të kontrolluar gjatë vitit. Kështu të ndara sipas llojit të aktiviteteve ekonomike subjekte të inspektuara rezultojnë:


Bujqesi, pyje, peshkim	88
Miniera kariera	173
Ndermarrje Prodhuese	1860
Elektricitet, gaz, uje	69
Tregeti, hotel-bar-restorante	5555
Ndertim	765
Transport, magazinim, telekomunikacion	209
Finance, shërbime të sigurimeve	464
Aktivitete të tjera	1707

Inspektive




- Rritja ndjeshëm e besimit ndaj institucionit, është e dukshme në numrin e rritur me 32 %, të inspektimeve për shkak ankese, krahasuar me një viti më parë.

Inspektime për shkak ankese




- Numri i inspektimeve për shkak ankese të kryera gjatë vitit 2014 nga Inspektorët e Degëve Rajonale, nuk është i vetmi numër aksesash të trajtuara nga Inspektorati. Ka dhe një numër të madh ankesash të trajtuara nga Inspektorët e Drejtorisë Qendrore.
- I krahasuar ky tregues ndër vite, tregon rritjen institucionale të inspektoratit dhe njëkohësisht na vë para përgjegjësi dhe kërkesave gjithnjë e në rritje ndaj vetes.

Inspektime për shkak Ankese



**Raport
2014**


- Rastet e ankesave të trajtuara, janë gjithnjë e në rritje. Janë gjithsej 214 ankesa nga 75 të një viti më parë (ose 3 herë më shumë), të ardhura pranë ISHPSHSH-së, nga të cilat 137 ose 64% me dokumentacion inspektimi, por jo vetëm. Gjatë këtij viti 21 prej tyre janë trajtuar nga Drejtoria Qëndrore e Inspektoratit të Punës, kurse pjesa tjetër e ardhur pranë Drejtorisë Qëndrore që i përkasin 90 % të ankesave të ardhura, janë deleguar rast pas rasti për tu trajtuar në Degët Rajonale përkatëse, sipas adresës së ushtrimit të aktivitetit të subjektit ndaj të cilit është drejtuar ankesa.
- 41% e ankesave janë trajtuar nga Dega Rajonale Tiranë
- 10% nga Drejtoria Qëndrore

Ankesa të trajtuara sipas DEGEVE

Sipas problematikave që ankuesit paraqesin në ankesat e tyre rezulton se:


- 59 ankesa kanë ardhur për paga të pamarra dhe mosderdhje të kontributeve të Sigurimeve Shoqërore për to, ose 27.6% e ankesave.
- 46 ankesa janë drejtuar për ndërprerje të marrëdhënieve të punës në mënyrë të padrejtë, si dhe pretendime që burojnë nga ligji për këto raste, ose 21.5% e ankesave.
- 46 ankesa për cenim të marrëdhënieve të punës, kryesisht për mospagesa të orëve shtesë të punuara mbi kohën normale të punës, mosrespektim i kontratës individuale të punës, ose 21.5% e ankesave.
- 18 ankesa për punësim të paligjshëm, të cilat kanë ardhur kryesisht anonime nëpërmjet rrugës elektronike.
- Pjesa tjetër janë të shpërndara për aksident në punë të panjoftuar nga punëdhënësi, mospagesë e raporteve mjekësore, diskriminim, refuzim nga punëdhënësi për firmosjen e Formularit të dyfishtë me qëllim përfitim asistence, kushte pune të pasigurta, ankesë për inspektorët e punës etj

Ankesat e ardhura në drejtim të:




Si rezultat i punës me profesionalizëm duke patur qëllim të punës marrjen e shërbimit të inspektimit nga cdo punëmarrës, ashtu sic përcaktohet në legjislacionin e punës na rezulton se janë zgjidhur 65% e ankesave të ardhura ose 140 prej tyre kryesisht në favor të punëmarrësve.

- Nuk janë zgjidhur 54 ankesa ose e thënë ndryshe 25 % e tyre për arsye se:
- Ankesa e ardhur pas verifikimit të bërë nga inspektorët e punës nuk u gjet e justifikueshme, ose problematika e ngritur në të nuk rezultoi e vërtetë.
- Kalonte kompetencat e inspektorit të punës sipas autoritetit që i jep ligji për të kërkuar zbatimin e tij.
- Ankues që ndërkohë që ankohen pranë Inspektoratit të punës kishin hapur dhe vazhdonin proces gjyqësor për të njëjtin objekt ankimimi.
- Janë zgjidhur pjesërisht, që do të thotë se nga disa pretendime të ngritura në një ankesë, jo të gjithë rezutojnë të jenë të vërtetë, 20 ankesa ose 9% .
- Vazhdojnë të vijnë ankesat për tu depozituar pranë degëve tona në formë të shkruar, pasi 80% e ankesave të ardhura janë depozituar në protokoll ndërkohë ardhur në mënyrë elektronike janë rreth 20 %.




- Implementimi i metodave të reja inspektuese, orientimi i procesit të inspektimit në drejtim të kontrollit të subjekteve që paraqesin rrezikshmëri të lartë në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë të punëmarrësve, apo dhe për evidentimin e punëmarresve të padeklaruar, i atyre që punojnë pa marë të drejtat që ju jep ligji për orët e zgjatura në punë, për punë të vështira e të pa paguara, ka çuar në rritjen e inspektimeve tematike, në 56% me shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Inspektime tematike



- Orjenitimi i drejtë i inspektimeve të programuara dhe tematike, ka çuar në rritjen e evidentimit të punëmarrësve informal në subjektet e liçensuara, krahasuar me të dhënat e një viti më parë. Kështu ka një rritje të ndjeshme me gati 5 herë të punëmarrësve informal evidentuar në inspektimet tematike, rritje në evidentimin e kësaj kategorie punëmarresish në inspektimet e programuara, apo në inspektimet për shkak ankese ku një vit më parë kjo shifër ishte 3.




15

**Raport
2014**

- Orjenitimi i inspektimeve drejt subjekteve të pa shkeluara më parë, duke synuar që të gjithë punëmarrësit në territorin e Shqipërisë të ndjejnë mbrojtjen e të drejtave të tyre të ligjshme, përmes institucionit të Inspektoratit të Punës. Krahësuar me një vit më parë ka rritje me:
 - 0.2% të inspektimeve në sektorin e bujqësisë.
 - 0.6% të inspektimeve në sektorin e minierave.
 - 4.3% të inspektimeve në sektorin e ndërmarrjeve prodhuese.


Duke ulur ne 2% inspektimin e aktiviteteve tregëtare. (të vetpunësuarit).

Në % më shumë inspektime në aktivitetet ekonomike




- Më shumë punëmarrës të informuar ndaj kërkesave, për kushte pune dhe mbrojtje në ushtrimin e profesionit të tyre, për kohëzgjatje pune, paga, sigurime, higjienë dhe mirëqenie, punësim të të miturve dhe grave brenda dispozitave ligjore, si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me to e të drejtat e tyre të ligjshme.

Mesatare e punemarresve per subjekt, evidentuar në inspektimet e kryera ndër vite



- Orjenitimi i drejtë i inspektimeve, ka çuar në rritjen e evidentimit të punëmarrësve që punojnë në turne të dyta, të treta, ditët e pushimit apo festave zyrtare, krahasuar kjo me këto tregues të një viti më parë. Janë 30 mijë punëmarrës të kësaj kategorie, evidentuar më shumë se një vit më parë.

Punëmarrës evisntuar në turn të II, III, në ditët e pushimit e të festave zyrtare



STATISTIKA TË VIZITAVE TË INSPEKTIMIT NË AKTIVITETET PRIVATE REALIZUAR NGA 12 DEGËT RAJONALE TË ISHPSHSH-SË


17

Raport
2014

- Numri mesatar i punëmarrësve për subjekt evidentuar në 12 prefekturat e Vendlit, gjatë viti 2014 është i ndryshëm duke dhënë dhe një panoramë në shpërndarjen e tyre varur kjo dhe nga natyra e aktiviteteve ekonomike të inspektuara në këto degë

Viti 2014		Aktivitete private		
		Subekte	Punëmarrës	Mes punm
1	Berat	542	7767	14.3
2	Diber	437	9258	21.2
3	Durres	1023	17828	17.4
4	Elbasan	958	10307	10.8
5	Fier	831	16783	20.2
6	Gjirokaster	557	2770	5.0
7	Korce	790	7698	9.7
8	Kukes	283	2082	7.4
9	Lezhe	397	8232	20.7
10	Shkoder	794	10984	13.8
11	Tirane	3258	63004	19.3
12	Vlore	947	10890	11.5
SHUME		10817	167603	15.5

- Të dhënat e mësipërme janë inspektime të raportuara nga Kryeinpektorët e degëve rajonale për çdo inspektor pune, si dhe nga grupet e punës të ngritura me Urdhër, e me inspektor pune, të cilët kanë raportuar kontrole në rajone të ndryshme.
- Numri më i madh i punëmarrësve për subjekt evidentohet në Diber me 21.2, më pas në:
 - Lezhë me 20.7 punëmarrësve për subjekt
 - Fier me 20.2 punëmarrësve për subjekt
 - Tiranë me 19.3 punëmarrësve për subjekt
 - Durrës me 17.4 punëmarrësve për subjekt




- Është evidentuar dhe raportuar në organet kompetente, punësim informal në subjektet e licensuar, me një diferencë të ndjeshme nga një vit më parë. Janë 26% më shumë informale të evidentuar dhe të raportuar në organet tatimore.

Punëmarrës të pa siguruar janë 1757 evidentuar në subjektet e licensuara, ku peshën më të madhe e zënë meshkujt.


Kështu:

Punëmarrëse femra te pa siguruara	630
ose 35.8% e punëmarrësve të pasiguruar	
Punëmarrës meshkuj te pa siguruar	1127
ose 64.2% e punëmarrësve të pasiguruar	



- Numri më i madh i punëmarrësve informal evidentuar në subjektet e liçensuara rezulton në subjektet me aktivitet:
 - Tregëti, hotel-bar-restorant me 43% të totalit të informalëve
 - Ndermarrje prodhuese me 21% në totalit të informalëve
 - Ndertim me 13% të totalit të informalëve
 - Aktivitete të tjera

Informal, evidentuar në subjektet e liçensuara




Viti 2014

Punëmarrës informal të evidentuar

1	Bujqesi, pyje ,peshkim	8
2	Miniera, kariera	69
3	Ndermarrje prodhuese	362
4	Elektricitet, gaz, uje	19
5	Tregti, hotel-bar-restorante	758
6	Ndertim	235
7	Transport, telekomunikacion	19
8	Finance, shërbime te sigurimeve	99
9	Aktivitete te tjera	188
Total		1757


- I krahasuar ky tregues ndër vite, tregon rritjen e evidentimit dhe raportimit pranë organeve kompetente të punësimit informal, dhe vënien para ligjit të çdo kujt që e shkel atë.

Punëmarrës informal, evidentuar në subjektet e licensuara



- Krahasuar me një vit më parë, janë 26% më shumë punëmarrës të pasiguruar, evidentuar gjatë inspektimeve të subjekteve private të licensuara.

Punëmarrës informal, në subjektet e licensuara



INFORMAL NË 12 DEGËT RAJONALE, EVIDENTUAR GJATË INSPEKTIMEVE NË SUBJEKTET E LIÇENSUARA

21

Raport
2014

- Numri i punëmarrësve të pa siguruar evidentuar në inspektimet e kryera në 12 Degët Rajonale rezulton të jetë më i lartë në degën rajonale Vlorë, me 35% të totalit të informalëve të evidentuar.


Aktivitete private

Viti 2014		Subjekte	Punëmarrës	Punm Informal ne subjektet e licensuara
1	Berat	542	7767	67
2	Diber	437	9258	198
3	Durres	1023	17828	148
4	Elbasan	958	10307	40
5	Fier	831	16783	60
6	Gjirokaster	557	2770	6
7	Korce	790	7698	117
8	Kukes	283	2082	107
9	Lezhe	397	8232	143
10	Shkoder	794	10984	38
11	Tirane	3258	63004	220
12	Vlore	947	10890	613
SHUME		10817	167603	1757

- Evidentimi i punëmarrësve të pasiguruar në disa prefektura është shume i ulët si në:

Gjirokastër, Shkodër, Elbasan, Fier

Punëmarrës Informal në subjektet e licensuara



- Nëpërmjet aksioneve të organizuar nga ISHPSHSH, rezultojnë këto të dhëna në 12 Degët Rajonale mbi ekonominë informale dhe punësimin krejtësisht informal në këto aktivitete.

22


Raport
2014

Nr	Dr/Rajonale	Subjekte të paliçensuara	P/ Informal në subjektet e Paliçensuar
1	Durrës	58	103
2	Dibër	254	288
3	Shkodër	380	675
4	Fier	95	188
5	Korçë	208	228
6	Elbasan	155	157
7	Lezhë	27	32
8	Gjirokastrë	81	81
9	Vlorë	99	140
10	Kukës	49	64
11	Tiranë	1466	2665
12	Berat	14	17
	Total	2886	4638

- Numri më i madh i aktiviteteve ekonomike informale dhe punësimit krejtësisht informal është evidentuar në degën rajonale Tiranë.


■ Subjekte të paliçensuara

■ P/ Informal në subjektet e Paliçensuar



- Numri më i madh i punëmarrësve të pasiguruar është evidentuar në aktivitetet tregtare. Kështu 43.1% e punëmarrësve të pasiguruar janë evidentuar në këto aktivitete, 20.6% e punëmarrësve të pasiguruar janë evidentuar në aktivitetet prodhuese, 13.4% në aktivitetet e ndertimit.

Punemarres informal, evidentuar ne subjektet e licensuar, sipas 9 aktiviteteve te ILO-s




- Nisur nga arsye inspektimi, në inspektimet rastësore informaliteti i evidentuar është 1.6 herë më i lartë (si %) sesa ai evidentuar në inspektimet tematike

Aktivitete Private

	Subjekte	Punmarres	Punëmarrës informal të evidentuar	% e Punëmarrës informal sipas llojit të inspektimit, kundrejt punemarresve informal të evidentuar
Inspektime Rastesore	8867	102666	964	54.87%
Inspektime Tematike	1729	34449	582	33.12%
Inspektime per Aksident	90	16097	14	0.80%
Inspektime per Ankese	131	14390	197	11.21%
	10817	167602	1757	

- Evidentimi, këshillimi dhe informimi, i punëmarrësve që punojnë në turne të dyta e të treta, me dispozitat ligjore për kushtet e punës dhe mbrojtje në ushtrimin e profesionit të tyre, për kohëzgjatjen e punës, pagat, sigurimin, higjienën dhe mirëqenien ka qënë një tjetër orjentim i inspektimeve. Kjo ka sjell rritje me 86% të evidentimit të punësimit në regjim pune ndryshe, me qëllim që të gjithë punëmarrësit në territorin e Shqipërisë të ndjejnë mbrojtjen e të drejtave të tyre të ligjshme.

**Punëmarrës në turn të dytë e të tretë, ditët e festave
zyrtare, ditët e pushimit**



MARRËDHËNIA E PUNËS E FINALIZUAR NË KONTRATË INDIVIDUALE PUNE

25


Raport
2014

Elementi kryesor për vënde pune të sigurt është nënshkrimi i një kontrate pune punëdhënës-punëmarrës. Elementët e saj janë pjesë e një sërë faktorësh në pasjen e një marrëdhënie të shëndoshë në punë.

Të dhënat e inspektimeve ndër vite tregojnë një ndërgjegjësim dypalësh në këtë drejtim, por ajo që është komplekse janë elementët e saj, conform legjislacionit e pa çënuar palët.

Të dhënat e mëposhtme janë evidentuar në subjektet private inspektuara në vite.

% e Punemarresve me kontrata individuale kundrejt totalit të punemarresve, evidentuar në inspektimet e kryera në vite



E parë në kënd vështrimin gjender, janë punëmarrësit meshkuj më shumë se punëmarrëset femra, të cilët punojnë dhe pa lidhur kontratë individuale me punëdhënësit.

Punëmarrëse **femra** me kontratë individuale
punemarresve me kontrata individuale

72099 ose 44.6% e


Punëmarrës **meshkuj** me kontratë individuale
kontrata individuale

89632 ose 55.4% e punemarresve me

- Përqindja më e madhe e punëmarrësve me kontrata individuale evidentohet në Fier me 99.1% e totalit të punëmarrësve të evidentuar në subjektet private të inspektuara gjatë vitit 2014.
- Përqindja më e ulët e punëmarrësve me kontrata individuale evidentohet në Kukës me 78.3% dhe Vlorë me 88.7% e totalit të punëmarrësve të evidentuar në subjektet private të inspektuara.

		Aktivitete private		Punm me	% e
Viti	2014	Subjekte	Punemarres	kontrata	Punmarresve me kontrata
1	Berat	542	7767	7622	98.1%
2	Diber	437	9258	9041	97.7%
3	Durres	1023	17828	16864	94.6%
4	Elbasan	958	10307	10202	99.0%
5	Fier	831	16783	16636	99.1%
6	Gjirokaster	557	2770	2536	91.6%
7	Korce	790	7698	7401	96.1%
8	Kukes	283	2082	1630	78.3%
9	Lezhe	397	8232	8033	97.6%
10	Shkoder	794	10984	10524	95.8%
11	Tirane	3258	63004	61580	97.7%
12	Vlore	947	10890	9662	88.7%
SHUME		10817	167603	161731	96.5%

% e Punmarresve me kontrata individuale kundrejt punëmarrësve të evidentuar në 12 degët rajonale



PUNËMARRËS ME KONTRATA PUNE, NE AKTIVITETE TË NDRYSHME TË EKONOMISË


27

Raport
2014


- Duke analizuar të dhënat mbi punëmarrësit e evidentuar me kontrata pune individuale në llojet e aktiviteteve të kontrolluara rezultojnë se, në aktivitetet elektrikitet, gaz ujë përqindja e punëmarrësve që punojnë me kontrata pune është më e ulët se në aktivitetet e tjera

Viti 2014	Punemarres	Punm me kontrata	% e punm. me kontrata individuale
1 Bujqesi, pyje ,peshkim	1976	1951	98.7%
2 Miniera, kariera	9216	9109	98.8%
3 Ndermarrje prodhuese	62514	60402	96.6%
4 Elektricitet, gaz, uje	2281	2142	93.9%
5 Tregti, hotel-bar-restorante	30138	28329	94.0%
6 Ndertim	17260	16709	96.8%
7 Transport, telekomunikacion	5016	4865	97.0%
8 Finance, sherbime te sigurimeve	5961	5731	96.1%
9 Aktivitete te tjera	33241	32493	97.7%
Total	167603	161731	96.5%

% e Punëmarrësve me kontrata individuale, kundrejt punëmarrësve të evidentuar, sipas llojit të aktiviteteve të inspektuara



- Punëmarrës **me aftësi të kufizuar** që punojnë _____ 127,
- Punëmarrës **të huaj** që punojnë _____ 2236,
- Punëmarrës **të huaj pa leje pune** _____ 27,
- Punëmarrës që punojnë **me kohë të pjesshme** _____ 551,
- Punëmarrës **që kryejnë punën në shtëpi** _____ 2,




STATISTIKA TË SUBJEKTEVE TË SANKSIONUARA GJATË VITIT

**Raport
2014**

- Numri i subjekteve të sanksionuara gjatë vitit 2014, është 110 me vlerë 32.878.000 lekë.
- Nga të dhënat e inspektimeve rezulton se 1% e aktiviteteve të inspektuara janë ndëshkuar me gjobë për shkeljet e evidentuara.
- Krahasimi ndërmjet numrit të subjekteve të gjobitura me numrin e subjekteve të inspektuara në 12 prefekturat e vendit paraqitet si më poshtë:

Nr.	Degët Rajonale	Nr. Subjekteve Private dhe Shtetore te inspektuara	Nr. i Subjekteve te sanksionuara	Vlere në leke e sanksioneve
1	Berat	554	5	230.000Lek
2	Diber	452	7	1,440.000Lek
3	Durres	1027	10	2,286.000Lek
4	Elbasan	958	4	2,620.000Lek
5	Fier	836	9	4,750.000Lek
6	Gjirokaster	557	0	0.000Lek
7	Korce	796	3	1,980.000Lek
8	Kukes	284	5	600.000Lek
9	Lezhe	403	3	1,540.000Lek
10	Shkoder	797	9	8,090.000Lek
11	Tirane	3258	29	6,472.000Lek
12	Vlore	968	26	2,870.000Lek
Numri Total		10890	110	32,878.000Lek

Subjekte te sanksionuara, në vite




Aktivitet e ndëshkuara me gjobë sigurisht rezultojnë ato aktivitete ku ka patur aksident në punë

Aktivitete Private dhe Shtetërore

	Nr. Subjekteve Private dhe Shtetërore te inspektuara	Nr. i Subjekteve te sanksionuara	Vlere në leke e sanksioneve
Inspektime Rastesore	8890	36	7,474.000Lek
Inspektime Tematike	1753	20	2,098.000Lek
Inspektime per Aksident	110	38	17,256.000Lek
Inspektime per Ankese	137	16	6,050.000Lek
Total Sanksione	10890	110	32,878.000Lek

Kështu:

- 35% e numrit të subjekteve të sanksionuara të jenë subjekte të inspektuara për **shkak Aksidenti në Punë**.
- 33% e numrit të subjekteve të sanksionuara të jenë subjekte të planifikuara për inspektim.
- 18% e numrit të subjekteve të sanksionuara të jenë subjekte të inspektuara për raste Tematike.
- 14% e numrit të subjekteve të sanksionuara të jenë subjekte të inspektuara për raste Ankese




Vlera e gjobave është shumë e lartë në rastet e aksidenteve në punë.

Kështu

- 53% e vlerës së sanksioneve, janë vendosur në raste aksidenti në punë.
- 23% e vlerës së sanksioneve, janë vendosur në raste inspektimi të planifikuar.
- 18% e vlerës së sanksioneve, janë vendosur në raste inspektimi Ankese
- 6% e vlerës së sanksioneve, janë vendosur në raste inspektimi Tematik

Sipas vlerë së sanksioneve të vendosuara, në rastet e inspektimeve:



Numri më i madh i sanksioneve rezultojnë të jenë vendosur në aktivitetet tregtare 32% e sanksioneve të vendosura gjatë inspektimeve, aty ku dhe është numri më i madh i aktiviteteve të inspektuara.

Viti 2014		Nr. i Subjekteve të sanksionuara	Vlerë në (.000) leke e sanksioneve
1	Bujqesi, pyje ,peshkim	1	660.000Lek
2	Miniera, kariera	11	8,490.000Lek
3	Ndermarrje prodhuese	21	6,206.000Lek
4	Elektricitet, gaz, uje	8	2,900.000Lek
5	Tregti, hotel-bar-restorante	35	4,106.000Lek
6	Ndertim	12	4,420.000Lek
7	Transport, telekomunikacion	2	420.000Lek
8	Finance, shërbime të sigurimeve	4	376.000Lek
9	Aktivitete të tjera	16	5,300.000Lek
Totale		110	32,878.000Lek

Punëmarrës nën 18 vjeç të evidentuar në subjektet e inspektuara gjatë vitit 2014, janë gjithsej 265.

Respektivisht moshë e tyre korrespondon:

- 16 vjeç 13.08 % e totalit të fëmijëve të evidentuar
- 17 vjeç 80.17 % e totalit të fëmijëve të evidentuar
- 18 vjeç 6.75 % e totalit të fëmijëve të evidentuar


Aktivitetet ku janë përqëndruar këta fëmijë janë:

- Ndërmarrje prodhuese 58%
- Përpunim peshku 12%
- Ndërtim 13%
- Tregëti 1%
- Aktivitete të tjera 16%


Arsimimi

- me arsim 9-vjeçar 92.4 %
- me arsim të mesëm 7.2 %
- me arsim fillor 0.4 %

Fëmijë evidentuar në vite



Fëmijë në punë, evidentuar në lloje të ndryshme aktiviteti



AKSIDENTE NË PUNË, RREGJISTRUAR PRANË INSPEKTORATIT

33

Raport
2014


- Pranë Sektorit të Insepktkimit të Sigurisë në Punë nga muaji Janar 2014 deri më Dhjetor 2014, janë **raportuar 120** raste të aksidenteve në punë, por të finalizuara si aksidente në punë janë regjistruar **111 raste**, ku kanë mbetur **të aksidentuar 121 punëmarrës**, prej të cilëve **33 kanë humbur jetën**.
- Nga hetimi i ngjarjes ka rezultuar se, në 9 (nëntë) raste **nuk kishim të bënim me aksident** në punë, sipas vlerësimit që bën ligji nr.10 237, datë 18.02.2010 'Për sigurinë dhe shëndetin në punë', të cilët kanë ndodhur në zonën e Beratit, Durrësit, Tiranës, Fierit, Dibrës.
- Rastet në fjalë janë shënuar në subjekte të palicensuara; kanë përfituar paaftësi të përkohshme në punë më pak se tre ditë kalendarike; ngjarja ka ndodhur për shkaqe natyrore, pa lidhje me kryerjen e punës; personi i aksidentuar punonte për llogari të tij, pa pasur një marrëdhënie punëdhënës-punëmarrës.
- Nga 121 punëmarrës të aksidentuar, **8 prej tyre janë femra dhe 113 meshkuj**. Femrat e aksidentuara janë me pozicion pune punëtore, në subjektet me aktivitet prodhim, shërbime dhe telekomunikacion.
- **Mosha mesatare** e punëmarrësve të aksidentuar është 35 vjeç. Punëmarrësit e aksidentuar, përveç rasteve me pasojë vdekje, **kanë pësuar** kryesisht diegie në fytyrë dhe këmbë, dëmtim të dorës, frakturë në shpinë apo këmbë, shembje trupore etj. Të aksidentuarit në fjalë përgjithësisht ishin me **pozicion pune** punëtor, zjarrmëtar, elektrikist, saldator, vagonist, mekanik, shofer.
- Ndaj 26 subjektve janë vendosur **masa administrative gjobë** për shkelje të rregullave të sigurisë në punë, apo mosnjoftim të aksidentit në punë pranë ISHPSHH-së. Në pjesën tjetër të rasteve janë vendosur dënime administrative paralajmërim për gjobë si dhe lënia e detyrave përkatëse me afatet respektive.

Nr.	Lloji i aksidentit	Të aksidentuar Total	Me vdekje
	Aksidente që lidhen direkt me punën	113(93.4%)	30(90.9%)
	Aksidente që lidhen direkt me punën (pa minierat)	77(63.6%)	22(66.6%)
	Aksidente në miniera	36(29.8%)	8(24.2%)
	Aksidente në rrugë	8(6.61%)	3(9.1%)
	TOTAL	121	33

Konstatohet që një numër i ndjeshëm i aksidenteve janë shënuar në miniera, 29.8% e rasteve. Po ashtu, minierat regjistrojnë dhe numër të lartë të aksidentuarve me pasojë vdekje, rreth 24.2 % e rasteve.

- Janë regjistruar 8 të aksidentuar në rrugë, që përshfihen si aksidente në punë, 3 nga të cilët kanë humbur jetën. Këtu janë përfshirë si rastet kur punëmarësi është aksidentuar gjatë linjës së drejtpërdrejtë nga banesa për në punë, si edhe rastet kur punëmarrësi po kryente punën sipas përshkrimit të saj dhe në këtë kohë është goditur nga një automjet.
- Aksidentet që lidhen direkt me punën, duke përjashtuar aksidentet në miniera dhe në rrugë, përbëjnë 63.6% të rasteve të aksidenteve të ndodhura. Kjo është dhe shifra reale e punëmarrësve të aksidentuar gjatë kryerjes së punës sipas përshkrimit të saj, pasi kujtojmë këtu që aksidentet në miniera dhe ato në rrugë, nuk janë në kontroll të drejtpërdrejtë të punës së inspektorëve të punës.

NR	Lloji i aktivitetit	Të aksidentuar	Me pasojë vdekje
1	Bujqësi, Pyje, Peshkim	-	-
2	Miniera, Kariera	36	8
3	Ndërmarrje Prodhuese	28	3
4	Elektricitet, Gaz, Ujë	19	12
5	Tregti, BRH	7	0
6	Ndërtim	16	8
7	Telekomunikacion	3	0
8	Financë, Shërbime	6	1
9	Aktivitete të Tjera	6	1
Totali		121	33



Në rang vendi janë monitoruar **208 subjekte** me aktivitet ndërtim dhe prodhim materiale ndërtimi, ku kemi këto rezultate konkrete:

- Janë lënë detyra për pajisjen dhe përdorimin e tyre nga punëmarrësit paisjet mbrojtëse individuale në **121 subjekte**.
- Në **3 subjekte** është lënë masa urgjente e pezullimit të punës, për shkak se u gjetën kushte flagrante të shkeljes së legjislacionit të punës që rrezikonte dukshëm jetën e punëmarrësve.
- Në **6 subjekte**, që ushtrojnë aktivitetin e tyre ndërtues përkatësisht në qarqet,
- Tiranë 2 subjekte, Vlorë , 2 subjekte. Berat 1 subjekt dhe në Shkodër 1 subjekt,
- të cilët nuk kanë reflektuar brenda afatit kohor të përcaktuar nga inspektorët e punës u është hapur procedura e inspektimit.
- Në **3 subjekte** është marrë vendim me sanksion në vlerën e 300 000 lekëve, për arsye se punëdhënësi nuk ka reaguar për përmirësimin e situatës në subjektin e tij.

Gjatë Vitit 2014 rezulton informacioni i mëposhtëm:

- në **840** subjekte ekziston dokumenti i vlerësimit të rrezikut,
- në **824** subjekte ekzistojnë punëmarrës që merren me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë ku numri i këtyre punëmarrësve është **3045**,
- në **150** subjekte rezulton ekzistenca e personave ose shërbimeve të specializuara jashtë ndërmarrjes për të organizuar aktivitete për mbrojtjen dhe parandalimin,
- në **189** subjekte ekziston koordinatori për SSHP kur subjekti punon me nënkontraktorë,
- në **521** subjekte ekzistojnë përfaqësuesit e Këshillit të SSHP,
- në **2731** subjekte ekziston shërbimi i ndihmës së parë, ku numri i personave të trajnuar është **11184**,
- në **2619** subjekte ekziston shërbimi i mbrojtjes nga zjarri, ku numri i personave të trajnuar është **13236**,
- në **1121** subjekte ekziston plani i evakuimit,
- në **1515** subjekte ekziston plani i formimit të punëmarrësve për SSHP sipas specifikave të vendit të punës,
- në **750** subjekte ekzistojnë **4135** punëmarrës që janë të pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit që merren me drejtimin e makinerive dhe pajisje transporti, mekanike ose elektrike dhe **154** punëmarrës janë pa leje,
- në **2287** subjekte ekzistojnë tabelat e SSHP,
- në **2363** subjekte ekzistojnë masat mbrojtëse kolektive,
- në **2344** subjekte ekzistojnë pajisjet mbrojtëse personale,
- në **124** subjekte ekzistojnë grupet e rrezikuara, ku nga këto **63** gra shtatzëna, **58** gra me fëmijë në gji dhe **59** persona me aftësi të kufizuara.

Drejtori rajonale	Nr. i subjekteve që mbulohen me shërbim mjekësor për periudhën janar-dhjetor 2014
Berat	63
Dibër	77
Durrës	112
Elbasan	53
Fier	60
Gjirokastër	15
Korcë	53
Kukës	5
Lezhë	116
Shkodër	85
Tiranë	475
Vlorë	73
Totali	1187

Nga tabelat e mësipërme rezulton se numri i mjekëve për periudhën Janar-Dhjetor 2014 është **1187 mjekë**, ndërsa kontrolli periodik i punëmarrësve ekziston në **2151 subjekte**. Për periudhën Janar-Dhjetor 2014 janë deklaruar **1853 punëmarrës me sëmundje profesionale**.


Numri i punëmarrësve që punojnë në vende pune të rrezikshme është **13223**, ndërsa numri i punëmarrësve që punojnë drejtpërdrejt me substanca të rrezikshme është **3271**.

Nr	Drejtoria Rajonale e ISHPSSH-së	Numri i punëmarrësve diagnostikuar për herë të parë			Numri i punëmarrësve me semundje profesionale gjithsej			Lloji i substancave të rrezikshme	Numri i punëmarrësve që punojnë me substanca të rrezikshme			Punëmarrës që punojnë në Vende Pune të Rrezikshme
		F	M	T	F	M	T		F	M	T	
1	Berat	0	0	0	0	0	0	48	84	464	548	500
2	Dibër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2674
3	Durrës	50	314	364	0	0	0	7	0	23	23	176
4	Elbasan	0	7	7	0	2	2	52	16	355	371	3718
5	Fier	19	41	60	0	1	1	10	17	285	302	1256
6	Gjirokastrë	33	40	73	0	0	0	8	16	27	43	847
7	Korçë	7	0	7	0	0	0	20	246	86	332	453
8	Kukës	0	0	0	0	0	0	36	16	190	206	113
9	Lezhë	0	0	0	0	0	0	14	13	96	109	314
10	Shkodër	374	422	796	0	0	0	0	0	0	0	307
11	Tiranë	0	0	0	0	0	0	2	7	68	75	1309
12	Vlorë	347	196	543	0	0	0	60	733	529	1262	1556
Total		780	1020	1850	0	3	3	257	1148	2123	3271	13223

Nga analiza e të dhënave nga këto tabela përse i përket substancave të rrezikshme rezultoi se:


- Në Berat përdoren 48 lloje substancash të rrezikshme si: Karburante, Diluent, Mastiç.
- Në Durrës përdoren 7 lloje substancash të rrezikshme si: Metanol, sodë kaustike, benzinat, pluhur gipsi, çimento reagen, butan, propan, pluhur argjili.
- Në Elbasan përdoren 52 lloje substancash të rrezikshme si: Derivate të hidrokarbureve, Naftë dhe nën produktet e saj, Sqfuri, Koks, Plumb, Karbon, Zink, Solar, Krom dhe komponentët toksik, lëndë plasëse.
- Në Fier përdoren 10 lloje substancash të rrezikshme si: Benzin, Naftë etj.
- Në Gjirokastrë përdoren 8 lloje substancash të rrezikshme si: Diluent, mastiç etj.
- Në Korçë përdoren 20 lloje substancash të rrezikshme si: HCl, Anoda Zinku, Sodë larëse, Bojra etj.
- Në Kukës përdoren 36 lloje substancash të rrezikshme si: Benzol, Benzin, Dinamit, Çimento, Kapsolla, Pesticide, Herpicide etj.
- Në Lezhë përdoren 14 lloje substancash të rrezikshme si: Diluent, karburante etj.
- Në Vlorë përdoren 60 lloje substancash të rrezikshme si: HCl, NH₄OH, NaOH, CO₂, CO, H₂S, mbetje klinike, medikamente, rreze regten, pluhur silici etj.

Ekzistenca e Shërbimit Mjekësor




- Siç vërehet nga grafiku i mësipërm, kemi një rritje të numrit të subjekteve që mbulohen me shërbim mjekësor, kjo si pasojë e orientimit të procesit të inspektimit dhe takimeve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere me biznesin në drejtim të përmirësimit të kushteve të punës, në subjektet që paraqesin risk për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve.

Ekzistenca e Paisjeve Mbrojtëse Kolektive




Paisjet Mbrojtëse Individuale





- Nga grafiqet e mësipërme vërehet se për vitin 2014 kemi një rritje të konsiderueshme të numrit të subjekteve që përdorin paisje mbrojtëse kolektive dhe individuale, kjo si pasojë e rritjes së numrit të inspektimeve në subjektet që paraqesin rrezikshmëri për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve si dhe zbatimi i Urdhërit Nr.1075 datë 08.04.2014, ku e gjithë trupa inspektuese u angazhua në kontrollin tematik në subjektet me aktivitet ndërtim dhe prodhim material ndërtimi, për krijim e një kulture ndërgjegjësimi për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale dhe kolektive, me qëllim uljen e numrit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale.

Nr. i Punëmarrësve me Sëmundje Profesionale



- Siç vërehet nga grafiku i mësipërm për vitin 2014 kemi ulje të numrit të punëmarrësve të diagnostikuar me sëmundje profesionale, kjo si pasojë e kontrollit të vazhdueshëm dhe insistues nga Inspektorati i Punës në drejtim të marrjes së masave kolektive dhe individuale të mbrojtjes, si dhe rritjes së numrit të subjekteve të cilat mbulohen me shërbim mjekësor.



- Nga grafikët e mësipërm vërehet një rritje e konsiderueshme e Këshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, dhe ekzistencës së dokumentit të vlerësimit të riskut, kjo si pasojë e kërkesës së vazhdueshme nga Inspektorati i Punës në këtë drejtim, jo vetëm për ngritjen e këtyre Këshillave por dhe në efektivitetin e tyre si dhe dokumenti i vlerësimit të riskut të jetë konform legjislacionit në fuqi

Fushat e inspektimit të Standarteve

- Shërbimet rezidenciale për të gjithë grupet në nevojë publike, jopublike, private (biznes social).
- Shërbimet ditore, gjysëm rezidenciale publike dhe jo publike
- Shërbimet komunitare të ngritura nga njësitë e qeverisjes vendore (Qarqe, Bashki, Komuna) dhe nga OJF-të.
- Shërbimet në fushën e edukimit, këshillimit dhe arsimimit, të drejtave të klientëve (fëmijë, gra, të moshuar, PAK, etj)
- Niveli i mirëqenies, sigurisë së jetës dhe sigurimit të kushteve të akomodimit dhe integritetit social, duke bashkëpunuar me strukturat e pushtetit lokal.
- Verifikim dhe ndjekje e rasteve të ankimeve të ndryshme të përfituesve në lidhje me shërbimet që u ofrohen, bazuar në standarte.

Institucionet e Përkujdesit Shoqëror që operojnë në fushën sociale :

- 266 subjekte jo publike dhe private të mbështetur nga donatorë të ndryshëm të licencuar nga QKL dhe MMSR;
- 27 institucione publike që financohen me fonde nga buxheti i shtetit në varësi të pushtetit vendor 19 institucione dhe 8 janë institucione kombëtare në varësi të MMSR dhe SHSSH.

Inspektimet e realizuara të ndarë sipas Qarqeve:

➤ Qarku Tiranë riinspektuar)	112	subjekte të inspektuar (	22	subjekte të
➤ Qarku Shkodër	20	“	“	
➤ Qarku Durrës	11	“	“	
➤ Qarku Elbasan	12	“	“	
➤ Qarku Vlorë	7	“	“	
➤ Qarku Lezhë	10	“	“	
➤ Qarku Gjirokastrë	4	“	“	
➤ Gjithësej Drejtoria	196	subjekte të inspektuar		
➤ Degët Rajonale	38	“	“	
➤ Gjithësej	234	subjekte		
➤ Qendra të mbyllura	14			

Sipas llojit të shërbimit janë realizuar inspektimet në subjektet për :

Femije	62 subjekte (23 R + 39 D)
PAK	33 (10 R + 27 D)
Të Moshuar	26 (12R + 14 D)
Viktima të trafikimit dhe të dhunës	6 “ (6 R -)
Gra/te rinj	19 “ (5 R + 13 D)
Q. Multidisiplinare	50 “
Gjithsej	196 subjekte të inspektuara nga

Drejtoria e Standarteve

Degët Rajonale 38 subjekte (Inspektim të Përgjithshëm).

Total **234 subjekte publike dhe jo publike.**

Mbetën për tu inspektuar në vazhdim për vitin 2015 dhe **32 Qendra të Përkujdesit**
në Qarkun

Korçë, Berat, Fier, Kukës dhe Dibër.

Problematika të evidentuara në subjektet e inspektuar.

Qendrat e përkujdesit janë të fokusuara në zbatimin e standarteve që lidhen me aspektet fizike (ushqimi, veshja, akomodimi,) dhe kanë vështirësi në zbatimin e standarteve që lidhen me aspektet psiko-sociale të klientëve, me përfshirjen sociale, rintegrimin, pjesmarrjen e prindërve/të afërmve në procesin e hartimit të planeve individuale, lidhjet me komunitetin etj.

Në disa institucione personeli ka mangësi në drejtim të figurave profesionale dhe mungesë e ekipit të plotë multidisiplinare, kapaciteteve/kualifikimeve profesionale për trajtimin e fëmijëve sipas grup-moshave, apo dhe përfituesve të tjerë.

Zbatimin e procedurave, hartimin e planeve të përkujdesit social sipas formatit të miratuar.

Mungesa e një plani të detajuar të përkujdesit shoqëror me të gjitha rubrikat si dhe përcaktimi i të gjitha nevojave të përfituesve.

Në disa institucione humanitare, të cilat kujdesin e bazojnë në parimet e bamirësisë, ka vështirësi për të kuptuar dhe zbatuar procedurat e parashikuara në standartin për ankimimin.

Ndjekja e procedurave për marrjen e kujdestarisë ligjore me vendim gjyqate, mbështetur në

Udhëzimin Nr 6. dt 21.05.2014, duhet të zbatohet në të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror.

Nevoja e trajnimit të burimeve njerëzore (punonjës social, psikolog, infermiere, fizioterapistë, kujdestarë, duke përfshirë dhe prindërit e klientëve). Personeli në Shtëpitë e të moshuarve të trajnohet sidomos në fushën e gerantologjisë.

Janë konstatuar ambiente masive në mjaft institucione, të cilat kanë nevojë për rikonstrukcion në përgjithësi, meremetim (ambiente me lagështirë) lyerje të përgjithshme të godinave.

Krijimi i strukturave dhe ambienteve të veçanta në lidhje me mbrojtjen dhe zgjidhjen e problemeve të klientëve që kanë nevojë për shërbime emergjente.(infermier, kutia e emergjencës, ambienti i veçantë me pajisjet e duhura).

Përmiresimi i infrastrukturës dhe pajisjes me mjete elektro-shtëpiake industriale në institucionet e përkujdesit shoqëror, kryesisht publike.

Komunitetet rom-egjyptian, duhet të mbështeten në vazhdimësi nga aktorët socialë në mënyrë që projektet në këtë drejtim, të mos ndërpriten për efekt financiar.

Masat e marra në vitin 2014

Pezullimin e veprimtarisë së subjektit Fondacionit “Shtëpia e Shpresës” Elbasan, që ofron shërbime deri sa të plotësohen standartet e rekomanduara. Për rrjedhojë, Komisioni i Shqyrtimit dhe Dhënies të licensave të institucioneve në MMSR, **vendosi revokimin e licensës për “Shtëpinë e Shpresës” Elbasan.**

Paralajmërim për mosplotësim të detyrave të lëna në afatin e përcaktuar kohor, deri në heqjen e licensës dhe mbylljen e aktivitetit tek Qendra Private “Joshua Center” Tiranë.

Propozimin për largim nga puna të znj. Merita Grazda, (kujdestare në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor Shkodër), për mos zbatim të detyrës, duke cënuar sigurinë e jetës dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

- Në kuadër të Javës Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, me mbështetjen e projektit IPA-2010 është realizuar spoti publicitar në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë, i cili është transmetuar në disa televizione, gjithashtu kemi lançuar fushatën mbarë Europiane ku ne jemi pjesë e saj, e cila për dy vjet do të fokusohet në “Menaxhimin e stresit në vendin e punës”.
- Në kuadër të përmirësimit të procesit të inspektimit në subjektet që paraqesin rrezikshmëri për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve, iu është dërguar gjithë Drejtorive Rajonale të ISHPSHSH-së, Udhëzimi në lidhje me subjektet që përdorin substanca të rrezikshme dhe evidentimin e punëmarrësve me sëmundje profesionale.
- Për zbatimin e Ligjit Nr.75/2014 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, iu është dërguar të gjitha Drejtorive Rajonale Urdhëri Nr.3024 datë 03.11.2014, ku deri tani nga inspektimet në terren nuk ka pasur shkelje të këtij ligji.

Të gjithë punonjësit të ankimohen kur janë të pasiguruar, kur nuk kanë kontratë pune dhe kur shkelen të drejtat që burojnë nga kjo kontratë

Lufta ndaj informalitetit në tregun e punës është një sfidë jo vetëm e vendit tonë por edhe e vendeve të Bashkimit European.

Eshte nje detyrim ligjor dhe human qe 1 nder 10 te punesuar te jete i aftesuar per ofrimin e nje ndihme te shpejte dhe cilesore

Funksionimi i mire dhe real i ketyre keshillave, ku vleresohet dhe vendoset te merren ato masa teknike per permiresimin e kushteve te punes, me qellim parandalimin e aksidenteve dhe te semundjeve profesionale do te jete nje prioritet i Inspektoriatit te Punes ne bashkepunim me perfaqesuesit e ndermarjeve dhe me perfaqesuesit e punonjesve



Komponenti i lirisë së punës ne Shqipëri, ka pësuar një rritje në 52.9% nga 49.7%, që ishte një vit më parë. (www.heritage.org/index)



Kemi krijuar nje klime te mire bashkepunimi me biznesin, korrekt me ligjin, si nje faktor shume i rendesishem ne luften kundër fenomenit të punësimit ilegal apo mosdeklarimit të pagave reale nga punëdhënësit për punëmarrësit e tyre